



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:158018

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517618

C.nr.505/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditëses K në likujdim e përfaqësuar nga N.L, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F (S) Th, nga fshati Xërxë Komuna e Rahovecit, lidhur me çështjen kontestimore për rimbursimin e mjeteve në emër të dëmit, vlera e kontestit 646.00 euro, më datë 27.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditëses K në likujdim e përfaqësuar nga N.L, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F (S) Th, nga fshati Xërxë Komuna e Rahovecit, lidhur me çështjen kontestimore për rimbursimin e mjeteve në emër të dëmit, në vlerë prej 646.00 euro.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja K në likuidim përmes përfaqësuesi të saj, N.L, me datë 03.08.2022 ka paraqitur në Gjykatë padi për rimbursimin e mjeteve në emër të dëmit, kundër paditurit F (S) Th, nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë për kompensimin e dëmit, gjeti se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Me vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore C.nr.505/22 të datës 21.11.2022, kjo gjykatë e ka ftuar paditësen që në afat prej 15 ditësh, ta paguajnë taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa, se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, me datën 05.12.2022, dhe nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa që nuk ekzistojnë kushtet për lirim të saj nga pagesa e të njëjtës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 5 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: “ *Në qoftë se Paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr* ”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.505/2022, më datën 27.03.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.